



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 81

2002

Dhjetor

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i KM nr. 601, datë 4.12.2002	Për miratimin e rregullores së funksionimit të Institutit të Integritetit të Përndjekurve..... 2325
Vendim i KM nr. 602, datë 4.12.2002	Për miratimin e lejes së funksionimit të institucionit arsimor, jopublik, Medreseja "Hafiz Abdullah Zëmlaku". 2331
Vendim i KM nr. 611, datë 4.12.2002	Për një ndryshim në vendimin nr. 303, datë 1.7.1999 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e sistemit të akreditimit në arsimin e lartë"..... 2331
Vendim i KM nr. 616, datë 4.12.2002	Për përcaktimin e kategorive të tjera të grupeve të veçanta që përfitojnë nga ligji nr.8872, datë 29.3.2002 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"..... 2332
Vendim i KM nr. 627, datë 13.12.2002	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 215, datë 16.5.2002 të Këshillit të Ministrave "Për ngritjen dhe funksionimin e grupit negociator shqiptar për përgatitjen e negociatave me Komisionin Europian dhe shtetet anëtare të Bashkimit Europian për nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim-

Vendim i GJK
nr. 240, datë 16.12.2002

Asociimit”.....	
Me objekt shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve nr.1061, datë 16.9.1999 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 471, datë 10.4.2000 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (Dhoma e Këshillimit), si dhe nr. D-37, datë 22.6.2001 të Kolegjit Seleksionues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.....	2333
Shpallje kërkesë për shpronësim për ndërtim të objektit “Superstradës Vorë - Maminas, pjesë e superstradës Tiranë- Durrës”.....	2335
Shpallje kërkesë për shpronësim të objektit “Ndërtim i ujësjiellësit, të Kavajës”.....	2338
Shpallje kërkesë për shpronësim të objektit “Ndërtim i Ujësjiellësit të Korçës”.....	2340
Shpallje kërkesë për shpronësim të objektit “Depo uji e ujësjiellësit të Poloskës, Devoll”.....	2341

V E N D I M
Nr. 601, datë 4.12.2002

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË FUNKSIONIMIT TË INSTITUTIT TË INTEGRIMIT TË TË PËRNDJEKURVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 3 të ligjit nr. 8246, datë 1.10.1997 "Për Institutin e Integrimit të të Përndjekurve", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Miratimin e rregullores së funksionimit të Institutit të Integrimit të të Përndjekurve, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

RREGULLORJA
E FUNKSIONIT TË INSTITUTIT TË INTEGRIMIT TË TË PËRNDJEKURVE

HYRJE

Në hyrje të ndërtesës së Institutit të Integrimit të të Përndjekurve vendoset stema e këtij institucioni, dhe shkrimi Instituti i Integrimit të të Përndjekurve. Kjo rregullore përcakton mënyrën e funksionimit të këtij institucioni si edhe detyrat dhe të drejtat funksionale. Në këtë rregullore përfshihet përshkrimi i punës për çdo njësi, drejtori dhe sektor.

KREU I

I- Misioni dhe natyra juridike

1. IIP-ja harton programet dhe zhvillon politikat e integritit në jetën shoqërore shqiptare të ish të përndjekurve politikë të regjimit komunist, në përputhje me programin e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë.

2. IIP-ja është person juridik publik me seli në Tiranë dhe operon me degët e tij pranë çdo prefekturë. IIP-ja ka emërtesën dhe vulën e vet dhe ushtron aktivitetin e tij në përputhje me ligjin nr.8246, datë 1.10.1997 "Për Institutin e Integrimit të të Përndjekurve", dispozitave të kësaj rregulloreve dhe legjislacionin shqiptar në fuqi.

3. IIP është institucion buxhetor që varet nga Këshilli i Ministrave, me fonde që i shpërndan sipas aktivitetit dhe organikës në qendër dhe në degë. Çdo degë ka vullat përkatëse dhe pavarësinë e përdorimit të fondeve të planifikuara.

II- Objektivat

1. IIP-ja përpunon dhe trajton çështjet themelore që kanë të bëjnë me ish-të përndjekurit politikë nga regjimi komunist, në bashkëpunim me shoqatat kombëtare të ish-të përndjekurve politikë që kanë shtrirje në të gjithë Shqipërinë.

2. Për probleme të veçanta IIP-ja lidh me këto shoqata marrëveshje përkatëse, të cilat janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga ana e këtij instituti.

3. Në bashkëpunim me institucionet e tjera shtetërore dhe me shoqatat e ish-të përndjekurve politikë, merr masat e duhura dhe ndërton programe për realizimin e të gjitha të drejtave të ish-të përndjekurve politikë nga regjimi komunist në zbatim të ligjit nr. 7748, datë 29.7.1993 "Për statusin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist", që burojnë nga ligji nr.7514, datë 30.9.1991, për pafajsinë si dhe nga vendimi nr. 476, datë 10.10.1994 i Këshillit të Ministrave "Për procedurat e strehimit të ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga regjimi komunist".

KREU II

I- Detyrat e drejtorit të përgjithshëm të IIP-s

1. Drejtori i përgjithshëm i IIP-s emërohet dhe lirohet nga Këshilli i Ministrave me propozimin e shoqatave kombëtare të ish-të përndjekurve politikë, që zhvillojnë aktivitet në të gjithë vendin e janë regjistruar konform ligjit në fuqi.

2. Drejtori drejton dhe organizon të gjithë veprimtarinë e IIP-s. Ai e përfaqëson IIP-n, në të gjitha marrëdhëniet juridike dhe administrative me të tretët.

3. Siguron realizimin e objektivave të Institutit dhe përgjigjet për këtë para Këshillit të Ministrave.

4. Nënshkruan kontrata apo marrëveshje që IIP-ja, mund të lidhë drejtpërdrejt me institucione vendase apo të huaja, me qëllim arritjen e objektivave dhe qëllimeve të tij, pasi të ketë siguruar më parë financimet.

5. Raporton pranë Këshillit të Ministrave, konform akteve ligjore dhe nënligjore, për të gjitha kontaktet me organizmat qeveritarë apo joqeveritarë jashtë shtetit.

6. Mund t'ia delegojnë autoritetin e tij zëvendës drejtorit të institucionit për plotësimin e detyrave funksionale.

7. Ndjek administrimin nga ana e shoqatave kombëtare të ish-të përndjekurve politikë, të fondeve të dhëna nga ana e Institutit për aktivitetin e tyre.

8. Pezullon dhe shfuqizon urdhra apo veprime të Këshillit të Ministrave, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative.

9. Drejtori i IIP-s emëron dhe liron nga detyra personelin e institucionit, në përputhje me legjisllacionin në fuqi.

10. Miraton me shkrim kualifikimet dhe udhëtimet zyrtare që kryen brenda apo jashtë shtetit dhe kërkon informacion në lidhje me ecurinë dhe aktivitetin e tyre.

11. Përcakton objektivat dhe përparësitë, harton planet e punës tremujore apo njëvjeçare.

II. Zëvendës drejtori i përgjithshëm i IIP-s

1. Emërohet dhe lirohet nga Kryeministri me propozimin e shoqatave kombëtare të të përndjekurve politikë.

2. Zëvendës drejtori i IIP-s është zëvendësues administrativo-ligjor i drejtorit. Ai ndihmon drejtorin në plotësimin e misionit të Institutit të Integritetit të të Përndjekurve në zbatim të politikave të programit të Qeverisë Shqiptare. Me urdhër të drejtorit të përgjithshëm, mbulon fusha të caktuara të veprimtarisë së drejtorisë.

3. Zëvendëson titullarin në mungesë dhe me porosi të tij për të gjithë problematikën që i përket institucionit.

4. Përgjigjet para titullarit për drejtimin sa më cilësor dhe efektiv të punës në institucion, bashkërendon punën ndërmjet drejtorive, sektorëve në qendër dhe degëve të inspeksioneve në prefektura.

5. Zgjidh me iniciativë dhe përgjegjësi ato probleme që janë jashtë kompetencave të drejtorive, si dhe në mungesë të titullarit apo me autorizim të tij nënshkruan akte apo materiale të tjera që u dërgohen organeve kompetente.

6. Nxjerr detyrat që i ngarkohen institucionit nga Këshilli i Ministrave dhe merr masa për realizimin e tyre.

7. Ndjek, drejton dhe përgjigjet për përgatitjen dhe përpunimin e njoftimeve dhe materialeve të rëndësishme që i parashtrihen drejtorit të përgjithshëm për t'i paraqitur në Këshillin e Ministrave apo pranë organeve të tjera.

8. Në takimet me institucionet qeveritare dhe joqeveritare apo qytetarë të ndryshëm evidenton problemet dhe ndjek zgjidhjen e tyre.

9. Koordinon punën me institucionet e tjera shtetërore dhe joshtetërore për zgjidhjen e problemeve të ndërsjella.

10. Mban përgjegjësi për mbarrëvajtjen e punëve në institut.

KREU III

Rregulla të përgjithshme të punës në administratën e IIP

I- Për disiplinën e punës dhe format e komunikimit me publikun

1. Koha e punës në Institut përcaktohet në bazë të vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave, për caktimin e punës dhe të pushimit në institucionet e administratës shtetërore.

2. Nëpunësit mund thirren në punë nga eprorët e tyre dhe jashtë kohës normale të punës kundrejt kompesimit të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

3. Nëpunësit dhe punonjësit e IIP-së kanë për detyrë që gjatë kohës së punës të paraqiten në institucion me veshje të rregullt konform normave të etikës dhe gjatë gjithë kohëzgjatjes së kohës së punës të mbajnë në gjoks kartën e identitetit të punonjësit/nëpunësit.

4. Çdo punonjës/nëpunës është i detyruar që të shfrytëzojë me intensitet kohën e punës, të krijojë marrëdhënie të rregullta me eprorët, vartësit dhe kolegët, dhe kur del jashtë ambienteve të institutit në çdo rast, duhet të marrë lejen tek eprori përkatës, duke lënë njëkohësisht shënimin në librin përkatës pranë punonjësit të rojës së shërbimit, për kohën e daljes dhe të kthimit.

5. Shërbimet zyrtare brenda vendit bëhen me urdhër të titullarëve për drejtorët e drejtorive dhe për punonjësit brenda drejtorisë nga drejtori përkatës. Udhëtimet e shërbimit jashtë shtetit bëhen me miratim të drejtorit të përgjithshëm.

6. Çdo mungesë në detyrë bëhet me leje, veç rasteve të mungesave për arsye shëndetësore, për të cilat duhet të bëhet njoftimi telefonik në drejtorinë përkatëse, e cila njofton përgjegjësin e sektorit të organizim personelit duke i bashëngjitur njoftimit raportin mjekësor.

7. Komunikimi i administratës së IIP-së me të ish-të përndjekurit politik, dhe persona të tjerë të interesuar do të kryhet në bazë të afateve kohore dhe sipas procedurave të caktuara nga ligji nr.8485, datë 12.5.1999 "Për Kodin e Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë". Me anë të kësaj rregulloreje synohet që çdo kërkesë e të interesuarve të marrë përgjigje brenda afatit kohor prej 10 ditësh nga data e aplikimit.

8. Përjashtim nga afati i sipërpërmendur bën vetëm procedura dhe afati për lëshimin e vërtetimeve apo deklarimeve për efekt dokumenti të faktit që i interesuari ka fituar statutin e të përndjekurit politik. Çdo i interesuar mund të pajiset me këtë vërtetim brenda ditës në të cilën aplikon për pajisje me vërtetim.

9. Përgjegjësi i sektorit mban përgjegjësi tek drejtori përkatës në rast konstatimi të mosrespektimit të afateve dhe procedurave të lartpërmendura.

KREU IV

I- Drejtoritë

1. Drejtoritë janë njësi bazë e strukturave organizative dhe përgjigjen për fushat dhe elementët teknike të programit që ato mbulojnë.

2. Drejtoritë hartojnë dhe përgatisin në bashkëpunim me njera-tjetrën projektligje, projektvendime, projektakte, të tjera sipas fushave përkatëse, me qëllim zbatimin e programit të qeverisë.

3. Përpunojnë strategji afatmesme dhe afatgjata të veprimtarisë së institutit sipas fushave që mbulojnë duke pasur si prioritet, mbështetjen në opinionin e profesionistëve e të teknikienëve të fushave përkatëse.

4. Drejtoritë ndjekin në mënyrë konstante dhe raportojnë periodikisht tek eprorët për situatën teknike, financiare dhe problemet që hasen në drejtori gjatë veprimtarisë së tyre.

5. Kanë iniciativë për hartimin e projektakteve ligjore dhe nënligjore dhe të përmirësimit të atyre ekzistuese, iniciativë e cila vjen si pasojë e ushtrimit të veprimtarisë së përditshme dhe verifikimit të të metave dhe mangësive ose thithjes së opinionit të shoqatave kombëtare të ish-të përndjekurve politikë. Në çdo rast, përgjegjëse për bashkërendimin e punës, për hartimin e projekteve është drejtoria juridike, e cila angazhon me forma të ndryshme përfshirjen e të gjitha kapaciteteve njerëzore dhe logjistike brenda dhe jashtë strukturës së IIP-së, që mund dhe duhet të ndihmojnë.

II- Drejtori i drejtorisë

1. Emërohet dhe lirohet nga Kryeministri, me propozimin e drejtorit të përgjithshëm të Institutit të Integritetit të të Përndjekurve, pas tërheqjes prej këtij të fundit, të mendimit të shoqatave kombëtare të ish-të përndjekurve politikë.

2. Mbështetur në këtë rregullore, funksionimi harton përshkrimin e punës për çdo sektor, zyrë

dhe vend pune.

3. Në zbatim të detyrave që rrjedhin nga programet vjetore dhe periodike të miratuara në shkallë aparati, parashikon në planet mujore të punës të gjitha detyrat që i dalin drejtorisë sipas fushave përkatëse, ndjek sistematikisht plotësimin e tyre dhe çdo muaj bën analizën në nivel drejtorie. Evidenton personat përgjegjës në varësi të tij, të cilët me veprimet apo mosveprimet e tyre kanë penguar ardhjen e rezultatit të pritshëm në institut.

4. Bën shpërndarjen e korrespondencës që i adresohet drejtorisë dhe ndjek e kontrollon punën që bëhet nga përgjegjësat e sektorëve, zyrat dhe punonjësit për përcaktimin e dhënien e zgjidhjeve ligjore, në afatet e caktuara.

5. Kontrollon dhe siglon gjithë korrespondencën që përgatisin punonjësit e drejtorisë.

6. Në mënyrë të planifikuar, organizon takime pune dhe aktivitete të tjera me shoqatat kombëtare të ish-të përndjekurve politikë dhe informohet për problemet e ndryshme që hasen për çështje të cilat mbulohen nga drejtoria përkatëse dhe merr masa për zgjidhjen e tyre.

III - Përgjegjësi i sektorit

1. Përgjegjësi i sektorit, si rregull ka kompetenca organizative, bashkëvepruese dhe kontrolluese. Ai ushtron edhe kompetenca teknike brenda sektorit që mbulon sipas ligjeve, akteve nënligjore, urdhrave dhe udhëzimeve të posaçme.

2. Nënshkruan çdo lloj dokumentacioni që del nga sektori dhe u drejtohet instancave më të larta brenda institutit. Nuk ka kompetenca të nënshkruajë apo të marrë vendime për çështje që mund të sjellin pasoja financiare, me përjashtim të rasteve kur i lejohet me rregullore ose me urdhër me shkrim të titullarit apo zëvendësit të tij.

IV- Specialisti

1. Punon për zbatimin e detyrave të tij, të përcaktuara në rregulloren e IIP-s, në rregulloren analitike të drejtorisë dhe në misionin e detajuar të sektorit.

2. Punon në përputhje me shkallën e kualifikimit dhe të kërkesave të vendit të punës.

3. Kryen punën me profesionalizëm, saktësi dhe në afat të caktuar.

4. Nënshkruan çdo lloj dokumentacioni, raport ose informacion që ka të bëjë me punën e tij apo me detyrat që i janë ngarkuar nga eprori.

KREU V

Struktura dhe detyrat për çdo njësi

I- Drejtoria juridike dhe marrëdhëniet me jashtë

1. Si njësi e specializuar për problemet ligjore bën koordinimin e punëve midis drejtorive përkatëse dhe degëve në prefektura, në mënyrë që ligjet, vendimet apo urdhresat e qeverisë të gjejnë zbatim praktik.

2. Siglon urdhrat, udhëzimet apo shkresat e nxjerra nga institucioni në zbatim të legjislationit në fuqi.

3. Përfaqëson IIP-në si person juridik me autorizim të drejtorit të përgjithshëm në marrëdhëniet me të tretët për zgjidhjen e problemeve dhe çështjeve ligjore të paraqitura.

4. I jep konsulencë ligjore sektorëve të tjerë për problemet që dalin gjatë ushtrimit të punës së përditshme.

I.A) - Sektori i ligjshmërisë dhe statusit

1. Përgjigjet për bazueshmërinë në ligj të projekteve të hartuara nga ana e institucionit në kuadrin e programeve rehabilituese dhe integruese në dobi të të përndjekurve politikë.

2. Në bashkëpunim me drejtorinë ekonomike ndjek procedurat të dhënies dhe kompensimit pasuror apo diferencave të këtij kompensimi për të përndjekurit politikë që përfitojnë nga kjo e drejtë.

3. Trajton në çdo kohë të dhënat statistikore, për numrin e përgjithshëm të të përndjekurve sipas grupeve të përndjekjes të sistemuara në dosje dhe bën kompjuterizimin e këtij informacioni.

I. B) -Sektori i marrëdhënieve me jashtë

1. Studion dhe zbërthen ligjet, vendimet dhe udhëzimet e qeverisë që kanë të bëjnë me aktivitetin e institucionit në marrëdhëniet me botën e jashtme apo organizmat e huaja të akredituara në vendin tonë.

2. Përgatit dokumentacionin e nevojshëm për marrëveshje apo protokolle bashkëpunimi me institucione apo shoqata simotra, si dhe me donatorë të mundshëm qeveritar

7 dhe joqeveritarë brenda dhe jashtë vendit.

3. Organizon pritjen dhe trajtimin e përfaqësuesve apo grupeve të punës që vijnë në vendin tonë nga vende të ndryshme në kuadin e bashkëpunimit të mundshëm dy ose shumëpalësh.

4. Organizon protokollin e pritjes së këtyre përfaqësuesve apo grupeve të huaja, zhvillimit të bisedimeve dhe me drejtoritë përkatëse, harton programet e punës.

5. Mban dhe ndjek korrespondencën me këto institucione apo donatorë të mundshëm si dhe është autoriteti përgjegjës që ndjek praktikatat zyrtare me ambasadat e huaja të akredituara në vendin tonë për procedurat e sigurimit të vizave për shërbimet jashtë shtetit për punonjësit e institucionit.

I - Drejtoria ekonomike

1. Objekti i kësaj drejtorie është mbulimi i detyrave të përgjithshme në fushën alokimit, monitorimit dhe kontrollit të fondeve buxhetore dhe jobuxhetore, duke u mbështetur në legjislacionin dhe rregullat përkatëse në fuqi.

2. Merr pjesë në hartimin dhe ndjekjen, pas miratimit, të programeve ekonomike financiare të inicuar nga ana e institucioneve së bashku me drejtoritë përkatëse.

3. Administron fondet buxhetore të institucionit, si dhe ndjek zbatimin e ligjshmërisë financiare dhe atë të mbajtjes së kontabilitetit.

4. Analizon kryerjen e shpenzimeve, nxjerr konkluzione, propozon masa në rastet e shkeljeve të disiplinës financiare dhe buxhetore, informon çdo tremujor titullarin e institutit, si dhe dërgon evidencat e miratuara për realizimin e buxhetit në Ministrinë e Financave.

5. Ushtron analiza e kontrole të plota ose të pjesshme në subjektet e varësisë apo subjektet e tjera publike që financohen direkt nga instituti vetëm përse i përket masës së këtij financimi. Jep udhëzime dhe sqarime për evidencën kontabël apo mirë administrimin e fondeve të financuara.

6. Kontrollon bilancin e mbylljes vjetore të institutit, kryen analiza ekonomiko-financiare për probleme të veçanta, informon eporët për problemet që dalin nga shqyrtimi i bilanceve, si dhe paraqet propozimet përkatëse dhe masat që duhen marrë për përmirësimin e punës në institut përse i përket programit që mbulon.

III. Drejtoria e problemeve sociale

1. Bën studimin e nevojave imediate dhe të perspektivës të të përndjekurve politikë për çështje të rëndësishme jetësore si strehimi, punësimi, shkollimi, kualifikimi, mbrojtja në punë, rehabilitimi kulturor dhe shëndetësor etj. Paraqet propozime konkrete për zgjidhjen e tyre.

2. Angazhohet në përgatitjen e raportit për gjendjen e të përndjekurve politikë, strategjisë së planit kombëtar të veprimit e të dokumenteve të tjera, që lidhen me politikatat e integritetit të tyre në jetën sociale.

3. Organizon aktivitete të ndryshme për rehabilitimin dhe lartësimin e vlerave morale, shoqërore dhe politike të kësaj shtrese.

IV - Sektori i burimeve njerëzore dhe shërbimeve

1. Është përgjegjës për sistemin e menaxhimit të personelit, të organizimit të strukturave dhe organikave, të zbatimit dhe përmirësimit të procedurave, për përdorimin e pajisjeve dhe teknikës së institutit, si edhe për mbarëvajtjen e shërbimeve të ndryshme brenda institutit.

2. Përgatit dhe pasqyron dosjet për çdo punonjës të institutit, duke pasqyruar në to vlerësimet e punës dhe kualifikimet për secilin prej tyre. Ndjek në vazhdimësi gjithë lëvizjet e personelit duke i pasqyruar ato në dosjen e personelit, librin themeltar dhe librezën e punës, si edhe vjetërsinë e punonjësve nëpërmjet këtyre librezave.

3. Në bashkëpunim me drejtoritë dhe duke marrë parasysh kërkesat e nëpunësve harton planin e pushimeve vjetore dhe pas miratimit të titullarit ndjek zbatimin e saj.

4. Organizon shërbimin e dezurnit, shërbimeve dhe kontrollon lëvizjet e automjeteve.

5. Organizon punën për përgatitjen e udhëzimeve dhe rregulloreve për përgatitjen e personelit.

V - Sekretari - Arkiv

1. Në zyrën e sekretarit-arkivit administrohen të gjitha praktikatat e mbyllura për dhënien e statutit të të përndjekurit politik. Zyra e ushtron funksionin e saj konform ligjit nr. 7726, datë 29.6.1993 "Për fondin arkivor kombëtar dhe për arkivat", si edhe akteve të tjera nënligjore për këtë qëllim.

2. Informacioni i ndodhur në zyrën e sekretarit-arkivit trajtohet në përputhje me dispozitat ligjore të cilat marrin në mbrojtje të dhënat sensitive si edhe informacionet e klasifikuara sekret.

3. Ruan dhe mirëmban vulën dhe dokumentet e depozituara në sekretari, konform akteve

ligjore në fuqi.

KREU VI

I- Degët e IIP-së, pranë prefekturave

1. Këto njësi kanë marrëdhënie varësie nga qendra dhe në bashkëpunim të ngushtë me degët e shoqatave dhe me autoritetin lokal trajtojnë të gjitha problemet e të përndjekurve politikë në bazë.

2. Kanë për detyrë të evidentojnë dhe pasqyrojnë problemet e të përndjekurve dhe të dalin me propozime konkrete për zgjidhjen e tyre.

3. Mbledhin dhe përpunojnë kërkesat e të përndjekurve politikë e i japin zgjidhje atyre kërkesave të cilat janë brenda kompetencës së tyre. Kërkesat e tjera i përcjellin për zgjidhje në IIP-në, në qendër.

4. Mbledhin të dhëna dhe çdo informacion tjetër të kërkuar nga qendra brenda afateve të përcaktuara.

5. Me autorizim të drejtorit të IIP, përfaqësojnë institutin në marrëdhënie me të tretët brenda prefekturave që ata mbulojnë.

KREU VII

I - Mjetet dhe administrimi financiar

Mjetet financiare të funksionimit të Institutit të Integritetit të të Përndjekurve ndahen në tre kategori:

1. mjete financiare vjetore të miratuara nga Qeveria për zbatimin e politikave qeveritare;

2. mjete të tjera financiare të mundshme, për realizimin e projekteve në ndihmë të të përndjekurve politikë;

3. mjete financiare të siguruar nga donatorë publikë ose privatë, vendas apo të huaj.

Ngarkohet IIP-ja për zbatimin e këtij vendimi.

V E N D I M

Nr. 602, datë 4.12.2002

PËR MIRATIMIN E LEJES SË FUNKSIONIMIT TË INSTITUCIONIT ARSIMOR, JOPUBLIK, MEDRESEJA "HAFIZ ABDULLAJ ZËMBLAKU"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 44 të ligjit nr. 7952, datë 21.6.1995 "Për sistemin arsimor parauniversitar", të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes së funksionimit të institucionit arsimor, jopublik, fetar, të nivelit të arsimit të mesëm, medreseja "Hafiz Abdullah Zëmbaku" në Korçë.

2. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe e Shkencës për të përcaktuar modalitetet e funksionimit të këtij institucioni arsimor, jopublik, dhe për të ndjekur zbatimin e dispozitave, ligjore e nënligjore, për arsimimin, edukimin, formimin dhe kualifikimin në këtë institucion.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M

Nr. 611, datë 4.12.2002

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 303, DATË 1.7.1999 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE "PËR KRIJIMIN E SISTEMIT TË AKREDITIMIT NË ARSIMIN E LARTË"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 dhe 13 të ligjit nr. 8461, datë 25.2.1999 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr. 303, datë 1.7.1999 të Këshillit të Ministrave të bëhet ky ndryshim:

1. Pika 2 të ndryshohet si më poshtë vjon:

"2. Këshilli i Akreditimit është organ kolegjal. Anëtarët e këtij këshilli emërohen nga Ministri i Arsimit dhe i Shkencës, i cili miraton edhe statutin e këtij këshilli.

Këshilli përbëhet nga 9 veta, personalitete (akademikë, me tituj shkencorë e me përvojë), në fushën e arsimit të lartë, shkencës dhe të ekonomisë shqiptare.

Kryetari i Këshillit të Akreditimit emërohet nga Kryeministri, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës. Ai shpërblehet çdo muaj me 20 për qind të rrogës së profesorit, kurse anëtarët me 15 për qind të rrogës së profesorit."

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës, zëri "Mallra dhe shërbime të tjera".

3. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe e Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendimi hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

V E N D I M

Nr. 616, datë 4.12.2002

**PËR PËRCAKTIMIN E KATEGORIVE TË TJERA TË GRUPEVE TË VEÇANTA QË
PËRFITOJNË NGA LIGJI NR. 8872, DATË 29.3.2002 "PËR ARSIMIN DHE FORMIMIN
PROFESIONAL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe nenit 5 të ligjit nr. 8872, datë 29.3.2002 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës dhe të Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Grupe të veçanta, që përfitojnë nga ligji nr. 8872, datë 29.3.2002, përveç atyre të përcaktuara në nenin 5 të ligjit janë edhe:

- a) personat që përfitojnë nga programet e mbështetjes me të ardhura;
- b) personat që dalin të papunë nga ndërmarrjet dhe institucionet në proces reformimi, ristrukturimi dhe privatizimi;
- c) vajzat, nëna, të papuna;
- ç) vajzat dhe gratë e trafikuar;
- d) gratë e divorcuara, me probleme sociale;
- dh) personat që kthehen nga emigracioni me probleme ekonomike;
- e) të sapodiplomuarit, të paorientuar në tregun e punës;
- ë) personat që kanë vuajtur dënimin me burgim.

2. Ngarkohen Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale dhe Ministria e Arsimit dhe e Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

V E N D I M
Nr. 627, datë 13.12.2002

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 215, DATË 16.5.2002 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN E GRUPIT NEGOCIATOR SHQIPTAR, PËR PËRGATITJEN E NEGOCIATAVE ME KOMISIONIN EUROPIAN DHE SHTETET ANËTARE TË BASHKIMIT EUROPIAN, PËR NËNSHKRIMIN E MARRËVESHJES SË STABILIZIM-ASOCIIMIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6 e 29 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998, “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare” dhe të nenit 7 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Integrimin, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr. 215, datë 16.5.2002 të Këshillit të Ministrave të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në titullin e vendimit pas fjalëve “...Komisionin European...” të shtohen fjalët “...komunitetet europiane...”.

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë vijon:

“3. Anëtarët e grupit negociator shqiptar janë përgjegjës për ndjekjen dhe bashkërendimin e detyrave specifike, sektoriale, si dhe për këshillimin e ministrive dhe të institucioneve të tjera qendrore, përkatëse, për realizimin e negociatave për marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit me Komisionin European, komunitetet europiane dhe shtetet anëtare të Bashkimit European.”.

3. Pika 5,6 dhe 7 ndryshohen si më poshtë vijon:

“5. Anëtarët e grupit negociator, si përfaqësues të institucioneve përkatëse, përgatisin raporte e dokumente standarde dhe kontribuojnë në hartimin dhe projektimin e strategjive, të planeve dhe të projekteve për procesin e integrimit european, në bashkëpunim dhe bashkërendim me Departamentin e Integrimit, pranë Ministrit të Shtetit për Integrimin.

6. Anëtarët e grupit negociator t’i paraqesin drejtuesit të institucionit përkatës nevojat për burime, njerëzore dhe logjistike, për ndjekjen dhe plotësimin detyrave, të ngarkuara në kuadër të integrimit european.

7. Anëtarëve të grupit negociator shqiptar t’u jepet një shpërblim deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë në muaj, sipas përcaktimit të Ministrit të Shtetit për Integrimin, pasi të jetë bërë vlerësimi i veprimtarisë së tyre. Ky fond të përballohet nga buxheti vjetor, i miratuar për Këshillin e Ministrave.”.

4. Pas pikës 7 shtohet pika 8, me këtë përmbajtje:

“8. Anëtarët e grupit negociator emërohen nga Kryeministri, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Integrimin.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

V E N D I M
Nr. 240, datë 16.12.2002

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci	Anëtar i “““
Alfred Karamuço	Anëtar i “““
Kristofor Peçi	Anëtar i “““
Kujtim Puto	Anëtar i “““
Sokol Sadushi	Anëtar i “““
Gjergj Sauli	Anëtar i “““

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 4.11.2002, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.221 Akti që i përket:

KËRKUES: DAIDIANA SHEHU, përfaqësuar nga avokatët Hanëme Bakiu e Lulëzim Koka, me deklaram.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. RUSTEM LLESHI, përfaqësuar nga avokat Bexhet Agolli, me prokurë.
2. HYSEN LLEKU, në mungesë.
3. BASHKIA QYTETIT BURREL, në mungesë.
4. KOMISIONI I KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TË PRONAVE PRANË BASHKISË BURREL, në mungesë.

5. HYSEN KUKA, përfaqësuar nga avokat Lulëzim Koka, me deklaram.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimeve nr.1061, datë 16.9.1999 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr.471, datë 10.4.2000 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (Dhoma e Këshillimit), si dhe nr.D-37, datë 22.6.2001 të Kolegjit Seleksionues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Sipas kërkeses, Daidiana Shehu, vendimet e mësipërme duhet të shfuqizohen si antikushtetuese për këto shkaqe:

- Gjykimi i çështjes për të cilën është marrë vendimi nr.1061, datë 16.9.1999 është zhvilluar në mungesë dhe pa dijeninë e kërkeses dhe të gjithë të paditurve të tjerë.
- Në gjykatën e apelit, megjithëse çështja ishte dërguar për rigjykim, njoftimi për datën e shqyrtimit është bërë në kundërshtim me kërkesat e nenit 460/4 të Kodit të Procedurës Civile.
- Gjykata e apelit nuk ka respektuar as edhe mënyrën e zakonshme të njoftimit të parashikuar në nenin 460/3 të Kodit të Procedurës Civile.
- Shkeljet e mësipërme që përbëjnë proces jo të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42/1 të Kushtetutës, janë parashtruar në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, por prej kësaj Gjykate është vendosur mospranimi i tyre.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Gjergj Sauli, përfaqësuesit e kërkeses, të subjekteve të interesuara dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Personat e interesuar, Rustem Lleshi dhe Hysen Lleku, kanë ngritur në Gjykatën e Rrethit Mat një padi civile kundër të paditurve Daidiana Shehu, Hysen Kuka, etj., me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 2, datë 17.2.1994 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të Bashkisë Burrel, deklaramin e pavlefshmërisë së kontratës së shitjes së shtëpisë, kthyer me vendim të këtij komisioni dhe shpërblimin e dëmit. Kjo padi është shqyrtuar nga Gjykata e Rrethit Mat, e cila e ka rrëzuar atë me vendimin nr. 261, datë 26.12.1997.

Gjykata e Apelit Tiranë, që ka rishqyrtuar çështjen me vendimin nr. 1061, datë 16.9.1999, ka vendosur pranimin e padisë për anulimin e vendimit të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Burrel dhe për shpërblimin e dëmit dhe ka pushuar gjykimin e padisë për pavlefshmërinë e kontratës së shitjes së shtëpisë, pasi paditësit hoqën dorë prej saj.

Kundër vendimit të sipërm të gjykatës së apelit, kërkesja ushtroi rekurs duke kërkuar prishjen

e këtij vendimi, por Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 471, datë 10.4.2000, vendosi mospranimin e rekursit. Të njëjtën gjë ka vendosur edhe Kolegji Seleksionues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë me vendimin nr. D-37, datë 22.6.2001.

Në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese, Daidiana Shehu pretendon se në shqyrtimin e çështjes si në gjykatën e apelit dhe në Gjykatën e Lartë është zhvilluar një proces jo i rregullt ligjor.

Gjykata Kushtetuese, duke e përqëndruar kontrollin e saj vetëm në respektimin e normave kushtetuese prej gjykatave që kanë shqyrtuar çështjen, çmon se nga këto gjykata janë lejuar shkelje të rëndësishme, të cilat e bëjnë procesin gjyqësor të parregullt nga pikëpamja kushtetuese.

Këto shkelje u gjetën të pasqyruara dhe u vërtetuan në materialet e dosjes së administruar nga Gjykata Kushtetuese. Nga procesverbali gjyqësor i mbajtur në datën 16.9.1999 prej Gjykatës së Apelit Tiranë, rezultoi se njoftimi për datën e gjykimit të çështjes ishte bërë me shpallje, në kundërshtim me nenin 460/4 të Kodit të Procedurës Civile, që kërkon bërjen e njoftimit drejtpërdrejt palëve. Veç kësaj, gjykata e apelit nuk ka respektuar as mënyrën e zakonshme të njoftimit të parashikuar në nenin 460/3 të Kodit të Procedurës Civile, sepse njoftimi me shpallje për ditën dhe orën e gjykimit të çështjes, nuk është bërë në Gjykatën e Rrethit Mat, fakt ky që u provua me vërtetimin e kësaj gjykate nr.38, datë 17.11.1999.

Duke zhvilluar një gjykim pa praninë e kërkuar dhe të të paditurve të tjerë, për shkak të shkeljes së neneve 460/3 dhe 460/4 të Kodit të Procedurës Civile, gjykata e apelit ka vepruar në kundërshtim me nenin 33/1 të Kushtetutës, sipas të cilit kushdo ka të drejtë të dëgjohet në gjykimin e çështjes. Respektimi i të drejtës themelore të palëve në gjykim për t'u dëgjuar në procesin gjyqësor ka rëndësi të veçantë. Shkelja e kësaj të drejte nuk mund të lejohet, sepse prek drejtpërdrejt parimin e kontradiktoritetit në gjykim.

Shkelje të tilla ligjore të lejuara nga gjykatat e kanë bërë procesin gjyqësor të parregullt në kuptim të nenit 42/1 të Kushtetutës, prandaj kërkesa për shfuqizimin e vendimeve të mësipërme është e drejtë dhe çështja duhet të kthehet për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit Tiranë.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 31 e 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

V E N D O S I:

- Shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve nr.1061, datë 16.9.1999 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr.471, datë 10.4.2000 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë (Dhoma e Këshillimit), si dhe nr.D-37, datë 22.6.2001 të Kolegjit Seleksionues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë;

- Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Apelit Tiranë.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

SHPALLJE KËRKESE PËR SHPRONËSIM

Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim publik të pasurive të paluajtshme për ndërtim të objektit "Superstradës Vorë- Maminas, pjesë e superstradës Tiranë-Durrës".

Subjekti kërkuar i këtij shpronësimi është D.P. Rugëve.

Me anë të këtij publikimi në shtyp, kërkohet të vëmë në dijeni personat që preken nga ky shpronësim.

Vënia në dijeni konsiston në sipërfaqen që shpronësohet dhe masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Shpronësimit pranë Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit, për personat sipas listës emërore të mëposhtme.

Ky publikim do të jetë për një periudhë njëjavore dhe brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, personat që kanë emrat në listën emërore kanë të drejtën të paraqesin pretendimet e

tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit (Drejtoria e Monitorimit).

QARKU TIRANE

BASHKIA VORE, FSHATI MARQINET, MARIKAJ, KODER VORE, MUCAJ.

LISTA SHITES E PRONAREVE QE SHPRONESOHEN PER EFEKT TE NDERTIMIT TE
SUPERSTRADES VORE - MAMINAS (KM 0+180 - 6+279)

Nr.	Pronar		Nr.pas.	Toke are		Kulture bujqesore		Vlera leke	Shenime
	Emri	Mbiemri		sip.m2	lek/m2	vlera/leke	lek/m2		
1	Bashkim	Adem	89/36	264	1820	480480	16	4224	484704
2	Arbeta	Besim	89/42	150	1820	273000	16	2400	275400
3	Ilir	Seit	89	52	1820	94640	16	832	95472
4	Skender	Hatem	89/67	332	1820	604240	16	5312	609552
5	Arben	Mexhit	89/50	95	1820	172900	16	1520	174420
6	Fatmir	Elez	89/88	1520	1820	2766400	16	24320	2790720
7	Fisnik	Elez	89/12	1520	1820	2766400	16	24320	2790720
8	Mid'hat	Almanzalao	102/10	2710	1820	4932200	16	43360	4975560
9	Bajram	Dalip	102	500	1820	910000	16	8000	918000
10	Tushe	Hider	102/6	420	1820	764400	16	6720	771120
11	Riza	Vath	102/5	280	1820	509600	16	4480	514080
12	Hider	Rahman	102	525	1820	955500	16	8400	963900
13	A. K.U.S. GROUP	Gjoka	89/74	399	1820	726180	16	6384	732564
14	Rudina	Shefki	39/13	393	1820	715260	16	6288	721548
15	Rudina	Shefki	39/9	525	1820	955500	16	8400	963900
16	Rudina	Shefki	39/15	52	1820	94640	16	832	95472
17	Veli	Mehdi	39/26	10	1820	18200	16	160	18360
18	Aishe	Osman	29	242	1820	440440	16	3872	444312
19	Sali	Haxhi	30	119	1820	216580	16	1904	218484
20	Jakup	Haxhi	30	183	1820	333060	16	2928	335988
21	Arif	Murat	25	210	1820	382200	16	3360	385560
22	Reshit	Selman	83/12	20	1820	36400	16	320	36720
23	Gezim	Emin	83/13	171	1820	311220	16	2736	313956
24	Xhevdet	Avdulla	83/21	20	1820	36400	16	320	36720
25	Avdullah	Shaban	83/22	25	1820	45500	16	400	45900
26	Mehmet	Hasan	269/2	91	1820	165620	16	1456	167076

27	Asllan	Hasan	Bylyku	269/4	73	1820	132860	16	1168	134028	
28	Sherif	Besim	Bylyku	269/3	91	1820	165620	16	1456	167076	
29	i pidentifikuar			39/27	35	1820	63700	16	560	64260	PRETENDIM PRONESIE
30	i pidentifikuar			39/19	113	1820	205660	16	1808	207468	PRETENDIM PRONESIE
31	i pidentifikuar			39/8	72	1820	131040	16	1152	132192	PRETENDIM PRONESIE
32	i pidentifikuar			39/12	120	1820	218400	16	1920	220320	PRETENDIM PRONESIE
33	i pidentifikuar			39/16	195	1820	354900	16	3120	358020	PRETENDIM PRONESIE
SHUMA					11527	1820	20979140	16	184432	21163572	

Shenim ; Brenda afatit ligjor 15 dite pas publikimit, te gjithë pronaret qe jane me shenimin; plotesim dokumentacioni dhe pretendim pronesie, te paraqesin dokumentacionin e nevojshem ligjor(certifikate pronesie, harte treguese dhe kartelet) te noterizuara prane Sektorit te Shrponesimeve ne Drejtorine e Monitorimit.

SHPALLJE KËRKESE PËR SHPRONËSIM

Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit shpall kërkesën për shpronësim publik të objektit “Ndërtim Ujësjiellësi Kavajë”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është SH.A. Ujësjiellës-Kanalizime Kavajë. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkohet të vëmë në dijeni personat që preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe Turizmit për secilin person sipas listës emërore të mëposhtme.

Ky publikim do të jetë me periudhë njëjavore dhe brenda 15 ditëve nga data e fundit e publikimit në gazetë, personat që kanë emrat në listën emërore kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë kompetente (MRTT).

LISTA EMËRORE E PERSONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR NDËRTIMIN E UJËSJIELLËSIT TË KAVAJËS

Nr	Emri, atësia, mbiemri	Sipërfaqja m2	Çmimi Lek/m2	Vlera Lek
1	Fetah Faik Beu (Harizi)	400	700	280000
2	Lutfi Resmi Beu (Harizi)	1258	700	880600
3	Dylejman Halit Beu (Harizi)	428	700	299600
4	Rifat Arif Beu (Harizi)	260	700	182000
5	Salami Hakik Beu (Harizi)	700	700	490000
6	Izet Aqif Harizi	348	700	243600
7	Bardhyl Rexhep Shaba	790	700	553000
	Shuma	4184	700	2928800

Tabela Nr.1

**LISTA EMERORE E PERSONAVE QE U JANE DENTUAR PRONAT NGA NDERTIMI I
UJESJELLESIT TE KAVAJES**

Lloji i pasurive te paluajtshme: Kultura Bujqesore dhe Hardhi Rrushi

Nr.	Emri	Mbiemri	Kultura	Njesia e matjes	Shuma gjithsej	Cmimi	Leke	Adresa
1	Haqim	Gjini	Tershere	Kg	22	50	1,100	Komuna Helmas
2	Minyr	Vrapi	Grure	Kg	46	40	1,840	Komuna Helmas
3	Jakup	Vrapi	Miser	Kg	57	35	1,995	Komuna Helmas
4	Besim	Gjini	Tershere	Kg	31	50	1,550	Komuna Helmas
5	Osman	Gjini	Tershere	Kg	22	50	1,100	Komuna Helmas
6	Gani	Gjini	Tershere	Kg	36	50	1,800	Komuna Helmas
7	Alush	Matera	Terfil	Kg	7.5	300	2,250	Komuna Helmas
8	Nazmi	Lemeti	Hardhi rrushi	rrenje	160	200	32,000	Komuna Helmas
9	Haki	Camema	Hardhi rrushi	rrenje	90	200	18,000	Komuna Helmas
10	Halit	Lemeti	Tershere	Kg	42	50	2,100	Komuna Helmas
11	Dylaver	Gjini	Tershere	Kg	22	50	1,100	Komuna Helmas
12	Ismail	Kalaja	Grure	Kg	96	40	3,840	Komuna Helmas
13	Rexhep	Kalaja	Grure	Kg	294	40	11,760	Komuna Helmas
14	Besnik	Lemeti	Grure	Kg	57	40	2,280	Komuna Helmas
15	Flamur	Lemeti	Grure	Kg	57	40	2,280	Komuna Helmas
16	Fiqiri	Lemeti	Grure	Kg	50	40	2,000	Komuna Helmas
17	Reshat	Lemeti	Hardhi rrushi	rrenje	25	200	5,000	Komuna Helmas
18	Reshat	Lemeti	Tershere	Kg	44.8	50	2,240	Komuna Helmas
19	Ali	Lemeti	Grure	Kg	50	40	2,000	Komuna Helmas
20	Shpetim	Lemeti	Hardhi rrushi	rrenje	27	200	5,400	Komuna Helmas
21	Agim	Lemeti	Grure	Kg	96	40	3,840	Komuna Helmas
22	Ali	Daka	Jonxhe	Kg	3.2	600	1,920	Komuna Helmas
23	Shaqir	Daka	Jonxhe	Kg	2.4	600	1,440	Komuna Helmas
24	Muhamed	Daka	Jonxhe	Kg	2.8	600	1,680	Komuna Helmas
25	Murat	Daka	Jonxhe	Kg	1.08	600	648	Komuna Helmas
26	Faje	Daka	Jonxhe	Kg	8	600	4,800	Komuna Helmas
27	Dylaver	Daka	Jonxhe	Kg	4.55	600	2,730	Komuna Helmas
28	Harum	Kalaja	Terfil	Kg	3.6	300	1,080	Komuna Helmas
29	Vasip	Lemeti	Grure	Kg	86.4	40	3,456	Komuna Helmas
30	Besnik	Kalaja	Hardhi rrushi	rrenje	90	200	18,000	Komuna Helmas
31	Zir	Lemeti	Jonxhe	Kg	0.8	600	480	Komuna Helmas
32	Mustafa	Lemeti	Grure	Kg	96	40	3,840	Komuna Helmas
33	Shkurt	Gjini	Tershere	Kg	61	50	3,050	Komuna Helmas
34	Aqif	Lemeti	Tershere	Kg	30.8	50	15,400	Komuna Helmas
35	Ndrim	Lemeti	Hardhi rrushi	rrenje	25	200	5,000	Komuna Helmas
36	Isuf	Lemeti	Jonxhe	Kg	0.5	600	300	Komuna Helmas
37	Isuf	Lemeti	Hardhi rrushi	rrenje	25	200	5,000	Komuna Helmas
38	Skender	Lemeti	Tershere	Kg	38	50	1,900	Komuna Helmas
39	Petrit	Lemeti	Tershere	Kg	57.6	50	2,880	Komuna Helmas
40	Petrit	Lemeti	Hardhi rrushi	rrenje	25	200	5,000	Komuna Helmas
41	Vath	Gjini	Tershere	Kg	67.2	50	3,360	Komuna Helmas
42	Bisha	Gjini	Terfil	Kg	10	300	3,000	Komuna Helmas
43	Xhaferr	Lemeti	Jonxhe	Kg	11.5	600	6,900	Komuna Helmas
44	Hamdi	Lemeti	Hardhi rrushi	rrenje	30	200	6,000	Komuna Helmas
45	Ethem	Rrapushi	Hardhi rrushi	rrenje	5	200	1,000	Komuna Helmas
46	Ethem	Rrapushi	Patate	Kg	150	40	6,000	Komuna Helmas
Shuma							210,339	

Tabela Nr.2

LISTA EMERORE E PERSONAVE QE U JANE DEMTUAR PRONAT NGA NDERTIMI I UJESJELLESIT TE KAVAJES

Lloji i pasurive te paluajtshme: Kultura Bujqesore, Hardhi Rrushi dhe Dru Frutore

Nr.	Emri	Mbiemri	Kultura	Njesia e matjes	Shuma gjithsej	Cmimi	Leke	Adresa
1	Dyleman	Harizi	Tershere	Kg	151	70	10,570	Komuna Leka
2	Vullnet	Harizi	Tershere	Kg	14	70	980	Komuna Leka
3	Ramazan H.	Harizi	Tershere	Kg	21	70	1,470	Komuna Leka
4	Dashamir	Beu	Tershere	Kg	18	70	1,260	Komuna Leka
5	Engjell	Beu	Tershere	Kg	18	70	1,260	Komuna Leka
6	Binan	Beu	Tershere	Kg	18	70	1,260	Komuna Leka
7	Besim	Beu	Tershere	Kg	18	70	1,260	Komuna Leka
8	Syrja	Harizi	Jonxhe	Kg	1060	2	2,120	Komuna Leka
9	Bajram	Harizi	Tershere	Kg	18	70	1,260	Komuna Leka
10	Selman	Harizi	Tershere	Kg	52	70	3,640	Komuna Leka
11	Hajdar H.	Harizi	Jonxhe	Kg	960	2	1,920	Komuna Leka
12	Nexhip	Harizi	Jonxhe	Kg	560	2	1,120	Komuna Leka
13	Hajdar H.	Harizi	Jonxhe	Kg	420	2	840	Komuna Leka
14	Servete	Harizi	Jonxhe	Kg	120	2	240	Komuna Leka
15	Pellumb	Tafa	Jonxhe	Kg	440	2	880	Komuna Leka
16	Ramazan	Tafa	Jonxhe	Kg	720	2	1,440	Komuna Leka
17	Enver	Harizi	Tershere	Kg	40	70	2,800	Komuna Leka
18	Xhemal	Plaku	Fasule	Kg	36	70	2,520	Komuna Leka
19	Liman	Saraci	Jonxhe	Kg	2070	2	4,140	Komuna Leka
20	Idajet	Roshi	Grure	Kg	224	30	6,720	Komuna Leka
21	Fadil	Hoxha	Grure	Kg	272	30	8,160	Komuna Leka
22	Bardhyl	Shaba	Jonxhe	Kg	7350	2	14,700	Komuna Leka
23	Bedri	Harizi	Ullinj	rrenje	45	700	31,500	Komuna Leka
24	Rifat	Harizi	Hardhi	rrenje	480	300	144,000	Komuna Leka
25	Nuredin	Hoxha	Patate	Kg	240	40	9,600	Komuna Leka
26	Nuredin	Hoxha	Tershere	Kg	32	70	2,240	Komuna Leka
27	Rifat	Harrizi	Proces Verbal	punime			192,000	Komuna Leka
Shuma							449,900	

SHPALLJE KËRKESE PËR SHPRONËSIM

Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit shpall kërkesën për shpronësim publik të objektit “Ndërtim Ujësjiellësi Korçë.”

Subjekti kërkuar i këtij objekti është bashkia Korçë. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat që preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe Turizmit për secilin person sipas listës emërore të mëposhtme.

Ky publikim do të jetë me periudhë një javore dhe brenda 15 ditëve nga data e fundit e publikimit në gazetë, personat që kanë emrat në listën emërore kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë kompetente (MRTT).

Lista emërore e personave që do të shpronësohen për ndërtimin e ujësjellësit të Korçës

Nr	Emri, atësia, mbiemri	Sipërfaqja m2	Çmimi Lek/m2	Vlera lek
1	Fatmira Demirali Cucllari	500	700	350000
2	Eqerem Bektash Kupe	200	700	140000
	Shuma	700	700	490000

SHPALLJE KËRKESË PËR SHPRONËSIM

Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit shpall kërkesën për shpronësim publik të objektit “Depo uji e ujësjellësit të Poloskës, Devoll.”

Subjekti kërkues i këtij objekti është Komuna Qendër Devoll. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personin që preket nga ky shpronësim Z.Haxhi Hysen Gjoza. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe Turizmit për sipërfaqem 400 m2, me çmimin 1000 lekë/m2 dhe vlerë totale 400 000 lekë.

Ky publikim do të jetë me periudhë një javore dhe brenda 15 ditëve nga data e fundit e publikimit në gazetë, Z.Haxhi Hysen Gjoza ka të drejtë të paraqesë pretendimet e tij të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë kompetente (MRTT).

Nr	Emri, atësia, mbiemri	Sipërfaqja m2	Çmimi Lek/m2	Vlera lek
1	Haxhi Hysen Gjoza	400	1000	400 000
	Shuma	400	1000	400 000

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
 - pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë **Qendrës së Publikimeve Zyrtare** mund të gjeni:

- Kodin Penal (të azhurnuar);
- Kodin e Procedurës Penale (të azhurnuar);
- Përmbledhjen e legjislacionit në fushën e transporteve (Kodin Rrugor dhe ligjin për transportet, e azhurnuar);

Kodi Penal <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Mars, 2002	Kodi i Procedurës Penale <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Shtator, 2002	Kodi i Procedurës Civile <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Korrik, 2002	Kodi Rrugor <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Qershor, 2002
Kodi Penal Ushtarak <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002	Përmbledhëse legjislacioni në fushën e Përmbardimit <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002		

U dorëzua për shtyp më 13. 12. 2002

Doli nga shtypi më 14. 12. 2002

Tirazhi: 4250 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2002

Çmimi: 150 lekë